



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 7 paragrafi 2, nenit 8, nenit 9 paragrafi 1 dhe nenit 18 të Ligjit nr.04/L-212 për Financimin e Subjekteve Politike, nenit 1 paragrafi 2, nenit 5 dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullës nr. 14/2013 Mbi Financimin e Subjekteve Politike dhe Sanksionet, shpalljes së Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës, dhe Vendimit të KQZ numër 1845-2019 për Certifikimin e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme të 6 tetorit 2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 24.03.2020 merr këtë :

### V E N D I M

#### **mbi Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për periudhën nga 1 Prilli deri 31 Dhjetor të vitit 2020**

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton lartësinë e mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend sipas Rezultateve të Certifikuara me datë 27 nëntor 2019, gjegjësisht numrit të ulëseve të fituara, për financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike parlamentare dhe për mbështetjen e punës dhe aktiviteteve të secilit deputet.
- II. Shuma e mjeteve për financimin e aktiviteteve të subjekteve politike dhe për mbështetjen e punës dhe aktiviteteve të secilit deputet nga Fondi për periudhën nga 1 prill 2020 deri 31 dhjetor të vitit 2020 është 3,150,000.00 € dhe ndahet sipas numrit të ulëseve të fituara në Kuvendin e Kosovës, për subjektet politike dhe detajeve si në vijim:

AKRONIMI	EMRI I PARTISË	Numri i vendeve të fituara	Shuma për subjektin politike	Shuma për aktivitete të deputetëve
	Lëvizja VETËVENDOSJE!	29	685,125.00	76,125.00
LDK	LIDHJA DEMOKATIKE E KOSOVES	28	661,500.00	73,500.00
PDK	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS	24	567,000.00	63,000.00
	AAK-PSD KOALICIONI 100% KOSOVË	13	307,125.00	34,125.00
	NISMA SOCIALDEMOKRATE – ALEANCA KOSOVA E RE – PARTIA E DREJTËSISË	6	141,750.00	15,750.00
	SRPSKA LISTA	10	236,250.00	26,250.00
KDTP	KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI	2	47,250.00	5,250.00
	KOALICIJA VAKAT	2	47,250.00	5,250.00
NDS	NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	1	23,625.00	2,625.00




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



PLE	PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE	1	23,625.00	2,625.00
IRDK	INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	1	23,625.00	2,625.00
JGP	JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	1	23,625.00	2,625.00
PAI	PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	1	23,625.00	2,625.00
PREBK	PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	1	23,625.00	2,625.00
	<b>Totali</b>	<b>120</b>	<b>2,835,000.00</b>	<b>315,000.00</b>

- III. Për mbështetjen e punës dhe aktiviteteve të secilit deputet, Subjekti Politik ndanë mjete nga Fondi, sipas pikës II dhe në pajtim me Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike.
- IV. Obligohet Departamenti i Administratës dhe Përkrahjes, për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



---

Valdete Daka, Kryetare